

NJOFTIM MBI ANULIMIN E PJESEVE/LOT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Në përputhje me nenin 47 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)

Data: 03.06.2026

I. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”

Adresa: Rr. “Luan Haradinaj” nr.2, 10000 Prishtinë

II. Lënda e procedurës së prokurimit:

II.1 Titulli i kontratës: “Furnizim me pajisje të TI-së” Lot 2,3

II.2 Numërtimi i prokurimit: “BQK 25 023 111”

II.3 Lloji i procedurës: *Procedurë e hapur (neni 10 i Rregullës për Prokurimin në BQK)*

II.4 Lloji i prokurimit: “Furnizim”

II.5 Numri i tenderëve të pranuar:

Lot 2: Dy (2) ofertues

Lot 3: Nje (1) ofertues

III. Anulimi i procedurës së prokurimit:

III.1 Data e anulimit të pjesëve/lot të procedurës: 02.06.2026

III.2 Pjesët/lotet e anuluarat:

a) Pjesa/lot 2 “Furnizimi me serverë” dhe

b) Pjesa/lot 3 “Furnizim me server per perdorim ne IA”

III.3 Arsyet e anulimit: Anulimi i këtyre dy pjesëve/loteve të kësaj procedure të prokurimit bëhen në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në BQK”, konkretisht sipas nenit 47, paragrafët 2 dhe 3. Vendimi i Bankës Qendrore për anulim sipas nenit në fjalë vjen si rezultat e mos përmbushjes nga ana e tenderuesve të kushteve si vijon:

- a) Pjesa/lot 2 “Furnizimi me serverë”: Procedura e prokurimit për Lot 2 anulohet pasi që asnjëra nga ofertat e pranuarat nuk është vlerësuar si e përgjegjshme. Oferta e një operatori ekonomik tejkalon buxhetin e alokuar për këtë lot, ndërsa oferta e operatorit tjetër nuk i plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit.
- b) Pjesa/lot 3 “Furnizim me server per perdorim ne IA”: Procedura e prokurimit për Lot 3 anulohet për shkak se oferta e vetme e pranuar, ndonëse i plotëson kërkesat administrative dhe teknike, tejkalon buxhetin e alokuar për këtë lot.

IV. Ankesat

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar¹ mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

¹ “Palë e interesuar”, sipas pikës 1.26 të nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK” cilësohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.